

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Aktiviteti 2.6.6: Aktiviteti VI mbi tabelat ofruese përdoruese
Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë, me
fokus në tabelat ofruese përdoruese

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i realizuar nga
Søren Larsen dhe Peter Rørmose Jensen
Statistikat e Danimarkës

22 Shkurt – 04 Mars 2016

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-maili

*Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 39 83
Email: shl@dst.dk*

*Peter Rørmose Jensen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 38 62
Email: prj@dst.dk*

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.	4
1. Komentet e Përgjithshme.	5
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	6
2.1 Burimet e të dhënave.....	6
2.3 Statistikat e ASN-së për 2013.	6
2.3 PRODCOM statistikat.....	7
2.4 Sugjerimet në lidhje me grumbullimin dhe procesimin e statistikave industriale në të ardhmen.....	8
2.5 Outputi dhe inputi për NPISH.....	8
2.6 Outputi dhe inputi i Shpenzimeve Qeveritare.....	9
2.7 Konsumi final i Ekonomive Familjare.....	9
2.8 Krahësimi i burimit të dhënave për industri në total.....	9
2.9 Përcaktimi i përqindjes fillestare të marzhës të tregtisë.....	9
2.10 Strukturat e produktit të outputeve dhe inputeve të industrisë.....	9
2.11 Balancimi i ofrimit dhe përdorimit.....	10
3. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	10

Lista e Shkurtesave

CPA	Klasifikimi Statistikor i Produkteve sipas Aktivitetit në Komunitetin Ekonomik Evropian
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NACE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
NPISH	Institucionet Jo-Profitable që i Shërbejnë Ekonomive Familjare
PRODCOM	Lista e Produkteve në Komunitetin Evropian
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje ekzekutive.

Qëllimi i këtij misionit ka qenë finalizimi i projektit të krijimit të tabelës ofruese përdoruese, në kuadër të komponentit të llogarive kombëtare të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”. Sipas termave të references, qëllimi fillestar i projektit ka qenë studimi i fizibilitetit të krijimit të SUT, por ekspertët danezë kanë vazhduar projektin me ndërtimin e kapaciteteve dhe punën praktike në tabelat ofruese përdoruese për vitin 2013, bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion.

Pasi është marrë vendimi mbi klasifikimet për tu përdorur në SUT, është krijuar një bazë në Excel që përmban kornizën SUT. Në misionet paraprase, është përpunuar burimi i të dhënave dhe është standardizuar në mënyrë që të futet në kornizën Excel me ndihmën e Excel macros.

Disa burime të të dhënave kanë qenë në dispozicion prej fillimit të projektit. Dy burime të reja të rëndësishme, statistikat e ASN për vitin 2013 dhe Statistikat e reja PRODCOM për vitin 2014, është pritur të jenë të gatshme pas pushimeve verore në vitin 2015. Pasi kanë qenë të gatshme, është vërejtur që për përdorimin e tyre do të nevojitet më shumë punë se sa është pritur fillimisht.

Statistikat PRODCOM kanë pasur nevojë për disa kodime shtesë dhe statistikat e ASN për validime shtesë, para se të përdorshin për përcaktimin e objektivave për outputet dhe inputet e industrisë. Stafi i llogarive kombëtare në bashkëpunim me ekspertët danezë kanë realizuar kodimin dhe koreigjimet e nevojshme. Përvoja nga ky aktivitet me siguri do të jetë e dobishme për grumbullimin e këtyre statistikave në të ardhmen.

Për shkak të vonesave të mëhershme, puna me burimet e të dhënave ka marrë një kohë të konsiderueshme të misionit aktual. Gjatë misionit, të dhënat e fundit që mungonin janë futur në kornizën SUT. Pasi konsiderohet që puna e mbetur merr pak kohë, misioni është zgjatur në dy javë. Puna me burimet e të dhënave, megjithatë, ka marrë shumicën e kohës dhe nuk ka qenë e mundur të finalizohet balancimi i SUT në kohën në dispozicion.

Sidoqoftë, ne kemi arritur ta shfrytëzojmë kohën për të trajnuar shumicën e stafit të llogarive kombëtare në balancimin e anës ofruese dhe asaj përdoruese. Një numër i balanceve të produkteve është realizuar me kombinimin e korigjimeve manuale dhe atyre automatike. SUT për vitin 2013 me siguri mund të jenë plotësisht të balancuara, në një kohë relativisht të shkurtër, nëse stafi i ASK-së punon edhe në pjesët e mbetura duke shkëmbyer me ne përmes e-mailit materialet, që përmbajnë korigjimet manuale. Megjithatë, balancimi final kërkon asistencë nga ekspertët danezë. Ne e konsiderojmë këtë si zgjidhje të mundshme për të përfunduar projektin.

Sipas përvojës tone, një mision gjatë vitit të ardhshëm do të ishte i dobishëm në mënyrë që kapacitetet e ndërtuara të kenë efekt afatgjatë. Duhet të hulumtohet nëse është e mundur të realizohet një mision i tillë.

1. Komentet e përgjithshme.

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është misioni i shtatë, që i kushtohet përpilimit të Tabelave Ofruese-Përdoruese për vitin 2013 në kuadër të komponentit 2 të projektit, Llogarive Kombëtare. Misioni paraparak ka përfunduar para 14 ditësh dhe misioni aktual ka pasur për qëllim finalizimin e punës së mbetur në burimet e të dhënave dhe në balancimin e anës ofruese dhe përdoruese, në kuadër të kornizës SUT.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

Të përfundohet futja e të dhënave në kornizën Excel që përmban SUT:

- Përdorimi i të dhënave të ASN për vitin 2013 ka qenë i vështirë për shkak të një numri gabimesh sistematike në kodimin original të të dhënave. Në disa fusha, ka qenë e nevojshme përmirësohen këto gabime para se të përdorëshin për percaktimin e caceve për totalët e outputit të këtyre industrive.
- Aktivitetet e disa NPISH ende nuk janë përshkruar në teresi. Këto njësi duhet të klasifikohen nga NACE.
- Versioni i parë i përkohshëm i caceve për totalët e kolonave duhet të rishikohet dhe kompletohet me shifrat për ndërtimtari, tregti dhe aktivitetet e NPISH.
- Kur të jeni në dispozicion outputet prej tregtisë me shumicë dhe pakicë sipas industrive të tregtisë, në nivel 4 shifror, ato duhet të shpërndahen sipas produkteve si bazë për vlerësimin e përqindjeve fillestare të marzhave të tregtisë me shumicë dhe pakicë.
- Informatat në dispozicion mbi strukturat e produkteve për inputet e industrisë duhet të plotësohen sipas sugjerimeve, duke shfaqur inputet e tjera të mundshme në secilën industri.

Të balancohet ana ofruese dhe përdoruese e produkteve në kornizën SUT:

- Të azhurnohen të dhënat dhe formulat që përdoren në kornizën SUT, për kalkulimin e marzhave të tregtisë dhe transportit, taksave minus subvencionet në produkte dhe TVSH-në për të gjitha qelizat në anën përdoruese.
- T'i përshtatet përdorimi i secilit produkt anës ofruese në dispozicion të atij produkti.
- Të zbulohen rastet ku oferta ose përdorimi i produkteve specifike ka munguar apo është nënvlerësuar dhe të gjenden zgjidhjet për probleme të tilla.
- Të bëhen ndryshime në supozimet fillestare mbi totalët e outputit dhe inputit ose të përafrohen vlerat aktuale me objektivat e tyre.
- Të përfundohet me një grup të SUT, ku dallimet midis totalin e ofertës dhe totalin e përdorimit të marzhave të tregtisë dhe transportit mund të largohen, dhe ku taksat, subvencionet dhe vlerat e TVSH-së korrespondojnë me vlerat e ofruara nga të dhënat zyrtare.

Misioni është zgjatur në dy javë. Gjatë javë së parë, fokusi ka qenë në zgjidhjen e problemeve të tjera në burimet e të dhënave me ndihmën e një eksperti danez. Disa prej këtyre problemeve janë shtyrë për shkak të nevojës për validime të rezultateve nga ASN dhe PRODCOM, para se të përdoren për qëllime të llogarive kombëtare.

Gjatë javë së dytë, puna është fokusuar në gjetjen e zgjidhjeve të problemeve në balancim, me pjesëmarrje të dy ekspertëve danezë. Gjatë javës së kaluar, ne kemi arritur të praktikojmë balancimin e produkteve me stafin e llogarive kombëtare në ASK. Balancimi nuk është kompletuar, por është e mundur – me pak ndihmë gjatë fazës finale të balancimit – të përfundohet brenda disa javëve.

Pavaresisht faktit që termat e referencës e përshkruajnë projektin e SUT vetëm si studim fizibiliteti, ne kemi synuar të prodhojmë SUT të balancuar për vitin 2013, bazuar në burimet më të mira të mundshme të të dhënave për këtë vit. SUT i zhvilluar në këtë mënyrë me siguri mund të përmirësohet,

kur të ketë burime më të mira në dispozicion. Mund të jetë e përshtatshme të pritët një vit para se të përdoren këto rezultate si standard i ri për llogaritë kombëtare aktuale. Nëse do të ishte e mundur për ASK-në të përsërisin këtë aktivitet edhe për SUT 2014, me të dhëna më të besueshme të ASN, duke krijuar kështu një mundësi të fuqishme për ripozicionimin e serive të llogarive kombëtare në një standard të ri.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetje dhe pjesëmarrje në projekt. Puna e stafit të llogarive kombëtare në ASK ka qenë esenciale për rezultatet.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Burimet e të dhënave.

Hapi i parë në këtë projekt ka qenë të vendoset mbi klasifikimet, që duhet të përdoren për produktet, industrinë, grupet e konsumit dhe përdoruesve të tjerë finalë. Këto klasifikime duhet të definohen mirë si tërësi e klasifikimeve ndërkombëtare dhe duhet të jetë e mundur të vendosen tabela korresponduese në mes të klasifikimeve të përdorura në burimet e të dhënave dhe atyre që përdoren në SUT. Puna me tabelat korresponduese ka filluar në fillim të projektit. Në rastin e Kosovës, disa burime të të dhënave të nevojshme për popullimin e SUT kanë qenë në dispozicion në fillim të projektit:

:

- Bujqësia
- Statistikat e TVSH-së
- Statistikat e ASN-së për 2012
- Importet dhe Eksportet e mallrave
- Anketa e buxhetit të ekonomive familjare
- Inputi dhe outputi për qeverinë e përgjithshme si dhe strukturën e produkteve të detajuar për inputet e qeverisë.
- Taksat dhe subvencionet mbi distribuimin e produkteve sipas produkteve të definuar për SUT.

Burime të tjera të rëndësishme të të dhënave, statistikave të ASN-së për vitin 2013 dhe statistikave të reja PRODCOM është pritur të jenë të gatshme pas disa muajsh. Përderisa burimet që kanë qenë në dispozicion në fillim të projektit nuk kanë shkaktuar probleme të mëdha, dy statistikave të reja kanë pasur nevojë për korrigjime të konsiderueshme para se të përdoren.

2.3 Statistikat ASN për vitin 2013.

Në praktikë, detajet e ASN 2013 kanë qenë në dispozicion për konsulentët në misionin e mbajtur në Tetor 2015, kur titujt e tyre janë përkthyer nga gjuha Shqipe në Gjuhën Angleze. ASN ka përdorë pyetësorin e ri me një numër relativisht të madh të pyetjeve për përdorim të llogarive kombëtare. Megjithatë, për shkak të grumbullimit të tyre gjatë kohës së verës, shkalla e përgjigjes ka qenë e ulët. Në versionin, të cilin ne e kemi pranuar, shifrat për njësitë, që mungonin, janë imputuar bazuar në të dhënat zyrtare në dispozicion. Pas rishikimit të përmbajtjes, është vërejtur që një pjesë e përgjigjeve ka përmbajtur gabime, të cilat duheshin korrigjuar para përdorimit. Vlen të përmenden disa prej gabimeve tipike: si duket shumë të anketuar nuk e kanë bërë dallimin në mes të mallrave dhe shërbimeve nga prodhimi vetanak dhe, në anën tjetër, mallrave për rishitje. Shitjet dhe blerjet në prodhim janë raportuar shumë shpesh si mallra për rishitje edhe pse shihet qartë që ato i përkasin produkteve vetanake dhe lëndës së parë. Megjithatë, ka pasur raste kur ka qenë e kundërta.

- Hapja dhe mbyllja e inventarit shpesh është vendosur si mallra për rishitje edhe pse njësia nuk ka raportuar ndonjë aktivitet të tregtisë ose anasjelltas.

- Në shumë raste është raportuar hapja apo mbyllja e stokut deri sa të tjerat kanë munguar.
- Raste të ngjashme ka pasur në outputin e prodhimit, që nuk ka pasur përdorim korrespondues të materialeve, dhe të rishitjeve, që nuk kanë pasur blerje korresponduese të mallrave për rishitje.
- Shumica e njësive kanë paraqitur pagat dhe meditet, që kanë kaluar vlerën e shtuar bruto.
- Njësitë e tjera me vlera të larta për vlerën e shtuar bruto nuk kanë raportuar paga dhe meditje. Disa ndërmarrje ndoshta punësojnë vetëm anëtarë të familjes, por kjo duket të jetë një shpjegim i jashtëzakonshëm në shumë raste.
- Pyetësi i ASN-së ka përmbajtur pyetje të detajuara mbi aktivitete të ndryshme në kuadër të secilës ndërmarrje, si dhe outputet dhe inputet e produkteve të ndryshme të ndërmarrjeve. Në përgjithësi, këto pyetje kanë pasur një shkallë të ulët të përgjigjes dhe ne nuk i kemi përdorur. Në vend të kësaj ne jemi bazuar në rezultatet e PRODCOM për vitin 2014.

Validimi komplet i ASN dukej jorealit në mënyrë që ASN të përdorej për këtë projekt. Në vend të kësaj ne jemi fokusuar në ato gabime më me ndikim në vlerat e nevojshme për SUT. Blerjet, që kanë munguar, janë imputuar, bazuar në raportet mesatare në kuadër të grupeve të ndërmarrjeve të ngjashme. Vlerat e vendosura gabimisht në mes të mallrave për rishitje dhe produkteve vetanake/blerjeve të materialeve, janë larguar. Stoket e hapura apo të mbyllura, që kanë munguar, janë supozuar të kenë vlera më të përafërta me vlerat korresponduese të hapura apo mbyllura të inventarit. Dallimi në mes të aktivitetit të tregtisë dhe prodhimit të mallrave dhe shërbimeve i është kushtuar vëmendje e veçantë për shkak të influencës që ka pasur në madhësinë e marzhave të tregtisë në total. Me fitimin e përvojës është bërë e mundshme shkrimi i Excelit-macros, i cili në mënyrë të përsëritshme ka realizuar korrigjimet më të zakonshme në të dhënat e ndërmarrjeve. Në fund, rezultatet nga ASN kanë shfaqur nivelet e outputit dhe inputit të industrisë, që duken me të arsyeshme duke i krahasuar me statistikën e TVSH-së dhe llogaritë kombëtare ekzistuese.

Informatat e prezantuara në ASN në lidhje me pagat dhe meditet janë validuar duke i krahasuar me burimet zyrtare, dhe në përgjithësi konsiderohen të besueshme. Në shikim të parë duket që ka një nënraportim të GVA, përvojë nëse kjo mund të shpjegohet me ndërmarrjet që janë duke u mbyllur apo marrin ndonjë subvencion për prodhim. Si rregull i përgjithshëm, GVA duhet të mbulojë shpenzimet e punëtorëve, taksat e tjera dhe konsumin e kapitalit fiks.

Një analizë më e thellë nxjerr në pah që industrinë, që përmbajnë njësitë me deficite të konsiderueshme zakonisht përmbajnë njësitë, që nuk kanë të regjistruar kompenzimin e punëtorëve. Një shpjegim i mundshëm i pagave dhe mediteve, që mungojnë, mund të jetë që në raste të tilla kompenzimi i punëtorëve është imputuar. Megjithatë, është një mundësi tjetër, ku pagat dhe meditet prej burimeve zyrtare janë raportuar që i përkasin një njësie, por në fakt ato duhet të shpërndahen te një numër i njësive të ndërlidhura.

Duket reale që outputi prej disa industrive duhet të plotësohet për nënraportimin. Megjithatë, duhet pasur kujdes dhe të gjendet zgjidhja më pragmatike me plotësimet në këto industri, ku totali i industrisë për pagat dhe meditet duket i lartë në krahasim me GVA-në.

2.3 Statistikat PRODCOM.

Siç është cekur në raportet paraprake, statistikën e reja PRODCOM për vitin 2014 kanë qenë në dispozicion që nga misioni i mbajtur në Tetor 2015. Në atë kohë, outputet e industrisë janë koduar në CPA, derisa inputet e raportuara të industrisë janë përshkruar vetëm në tekst në Gjuhën Shqipe. Pasi informatat nga ASN mbi strukturën e produktit për outputet dhe inputet e industrisë kanë pasur një shkallë të ulët të përgjigjes, rezultatet nga PRODCOM kanë pasur rëndësi të veçantë për projektin SUT. Inputi nga PRODCOM sipas klasifikimeve të përdorura në SUT, është koduar nga stafi i llogaritë kombëtare. Një përpjekje për të përdorur kodet e njejta, siç janë përdorur për të koduar outputin e PRODCOM, ka treguar që shumë produkte me të njëjtin përshkrim këtu kanë kode tjera të produkteve. Në mënyrë që të largohen këto mospërputhje të të dhënave, stafi i llogaritë kombëtare po ashtu ka korrigjuar kodimin e outputeve.

Nevoja për kryerjen e kësaj detyre të paparashikuar ka vonuar punën në projektin SUT, por ka treguar rezultate pasi tani kemi versionin PRODCOM, qe duket të jetë i besueshëm. Nuk është i detajuar siç është kodimi origjinal i CPA, por megjithatë ofron një pikë referuese të mirë për kodimin e PRODCOM në të ardhmen.

2.4 Sugjerimet sa i përket grumbullimit dhe procesimit të statistikave të industrisë në të ardhmen.

Përvoja jonë në punën me ASN dhe PRODCOM, na ka ofruar mundësinë e përmbledhjes të disa sugjerimeve për grumbullimin e këtyre statistikave në të ardhmen:

- Pyetësorët duhet të përmbajnë pyetjet që janë të nevojshme për qëllime të llogarive kombëtare. Kur fillohet me një statistikë të re, kërkohet angazhim shtesë të mësohen të anketuarit në lidhje me konceptet e përdorura në pyetësor. Një shembull është dallimi midis mallrave nga prodhimi vetanak me mallrat për rishitje.
- Përshtypja e përgjithshme është që ka nevojë të përmirësohen njohuritë e intervistuesve për tu siguruar që e kanë kuptuar dhe mund të shpjegojnë këto dallime në pyetësor.
- Pyetjet sa i përket detajeve – edhe pse mjaft të dobishme – duhet të shmangen nëse janë shumë të vështira të përgjigjen nga shumica e të anketuarve.
- ASN fillimisht duhet të fokusohet në grumbullimin e të dhënave mbi totalin, pa shpërndarje të detajuar të produkteve. PRODCOM duhet të fokusohet në atë se si duhet të shpërndahen shitjet dhe blerjet sipas produkteve.
- Validimi preferohet të bëhet kur të pranohen pyetësorët. Shumica e gabimeve të gjetura në ASN 2013 kanë mundur të vërehen duke përdorur disa teste logjike të kryera në kohën kur janë futur të dhënat.
- Për shkak të stafit të kufizuar si numër, kërkimi i mëtejshëm për gabime duhet të fokusohet në njësitë e mëdha dhe të rëndësishme. Disa njësi më të rëndësishme duhet të kontakohen nëse ka ndonjë dyshim që nuk janë kuptuar pyetjet saktë.
- Gabimet evidente në përgjigje nga ndërmarrjet e vogla munden, në shumicën e rasteve, të korrigjohen në mënyrë automatike, duke përdorur metodat e ngjashme me ato që janë përdorur për të korrigjuar ASN për vitin 2013.
- Është e rëndësishme që të dhënat e grumbulluara prej burimeve të ndryshme t'i referohen njësitë të njëjta mirë të definuara. Ekzistimi i regjistrimit të ri të bizneseve mund të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme krahasimin në mes burimeve të të dhënave. Idealisht, raportet midis njësitë, të përdorura në burimet administrative, dhe njësitë në regjistrin e bizneseve, duhet po ashtu mirë të definohen.

2.5 Outputi dhe inputi për NPISH.

Puna në njësitë jo-profitabile ka filluar gjatë misionit paraprak. Një tabelë me kalkulimet për OJQ-të nga llogaritë kombëtare ekzistuese është përdorur si pikë referuese. Është vërejtur që derisa shpenzime administrative janë përfshirë në vlerat e prodhimit të këtyre njësitë, kostot e programeve dhe puna në terren është lënë jashtë në shumicën e rasteve. Në fillim të misionit aktual, ende nuk ka përfunduar klasifikimi i industrisë për shumë njësi.

Tani secila njësi është klasifikuar sipas kodit të industrisë 2 shifror. Një numër i NPI është klasifikuar si prodhues i tregut. Outputi i njësitë të sektorit të NPISH-së është koduar në mënyra të ndryshme si të ardhura nga shitjet dhe/ose outputit final jo-profitabil. Rezultatet janë sjell në një formë të standardizuar dhe janë futur në kornizën SUT.

Konsumi i ndërmjetëm dhe kompenzimi i punëtorëve është vlerësuar për secilën njësi dhe totali për inpute i është shtuar vlerave të objektivit për konsum të ndërmjetëm të industrive relevante.

2.6 Outputi dhe inputi i Përgjithshëm i Qeverisë.

Të dhënat nga llogaritë qeveritare përmbajnë kodim të detajuar të kostove, që i përkasin kategorisë COFOG. Korrespondenca midis këtij kodimi dhe klasifikimeve të përdorura në SUT është përshkruar dhe përdorur në misionin e mbajtur në Dhjetor 2015 për konvertimin e të dhënave të qeverisë në një format të standardizuar për inputet e të dhënave në SUT. Gjatë misionit aktual janë bërë disa korrigjime në klasifikimet e industrisë, ashtu që disa prodhime janë zhvendosur në industrinë 91, „Librari, arkivë, muze, kulturë”.

2.7 Konsumi final i ekonomive familjare.

Të dhënat nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare kanë qenë në dispozicion të koduara sipas grupeve COICOP. Gjatë misioneve në qershor dhe tetor 2015 është krijuar një tabelë korresponduese midis këtij kodimi dhe klasifikimit të produkteve, që përdoren në SU. Pasi totalët e peshuara të ABEF kanë qenë dukshëm më të ulta se që është pritur, shifrat e ABEF janë ngritur në nivele të llogarive kombëtare aktuale para se të futen në kornizën SUT si të dhëna fillestare për konsumin e ekonomive familjare. Duke pas parasyshë pasigurinë, vlerat fillestare mund të ndryshojnë si rezultat i procesit të balancimit.

2.8 Krahësimi i burimit të dhënave për total industrinë.

Gjatë misioneve paraprake janë hartuar tabelat për krahasimin e vlerave të gjetura në llogaritë kombëtare ekzistuese, statistikave të TVSH-së, statistikave ASN, llogarive qeveritare dhe të dhënave të bujqësisë për vitin 2013. Versioni i parë i vlerave për outputet dhe inputet e industrisë është modifikuar, fillimisht si rezultat i korrigjimeve të të dhënave të ASN-së. Tani është e mundur të shtohen të dhënat për ndërtimtari dhe tregti.

Janë shtuar shifrat nga burimet e reja të të dhënave. Gjatë misionit aktual ishte në dispozicion dhe regjistri i ri i bizneseve për Kosovë – që është rezultat i projektit të binjakëzimit. Ky regjistër përmban vlerat për qarkullim, pagat dhe medijt sipas industrisë.

Vlerat e synuara që janë përdorur si pikë referuese me siguri do të ndryshojnë si rezultat i procesit të balancimit. Për disa industri vlera e outputit me siguri do të rritet për të mbuluar nënraportimin, por plotësimet e sakta do të reflektojnë mospërputhjet e shfaqura gjatë procesit.

2.9 Përcaktimi i përqindjes fillestare të marzhave të tregtisë.

Outputi prej tregtisë tani është i bazuar në ASN dhe është në dispozicion sipas industrive NACE 4 shifror. Outputi prej secilës industri është shpërndarë sipas produkteve që mund të supozohen se tregtohen përmes kësaj industrie. Këto distribuime janë rregulluar për të marrë parasysh, që shumë produkte tregtohen përmes më shumë se një industrie 4 shifrore. Përfundimisht, përqindjet e marzhave të tregtisë janë kalkuluar për secilin produkt, duke i krahasuar me vlerat e produktit që mund të supozohet se tregtohet përmes tregtisë me shumicë dhe/ose pakicë. Këto përqindje të marzhave të tregtisë janë futur në kornizën SUT, ku janë përdorur sipas formulave që kalkulojnë marzhat e tregtisë me shumicë dhe pakicë në secilën qelizë të matricës së anës ofruese.

2.10 Strukturat e produktit të outputeve dhe inputeve të industrisë.

Korniza SUT tani përmban një matricë të plotë të anës ofruese. Siç është përmendur më lart, disa outpute mund të rregullohen sipas ndryshimeve eventuale në totalët e industrisë.

Një matricë e përdorur fillimisht, po ashtu është futur në sistem. Ajo përmban vlerat e njohura të inputeve në bujqësi, qeverinë e përgjithshme si dhe vlerat e bazuara në përdorimin e statistikave PRODCOM dhe konsumit të ekonomive familjare bazuar në ABEF. Përdorimi final i outputeve të jo-

tregut të NPISH dhe qeverisja e përgjithshme, po ashtu janë të njohura prej kalkulimeve të outputit të jo-tregut. Vlerat “e njohura” megjithatë, nuk korrespondojnë me të gjithat vlerat në dispozicion dhe sugjerimet për përdorimin e produkteve të tjera janë shtuar në versionin fillestar të matricës në përdorim. Shumica e “inputeve të sugjeruara” janë larguar prapë, gjatë balancimit të secilit produkt.

2.11 Balancimi i ofertës dhe përdorimit.

Në kuadër të misionit aktual, korniza SUT më në fund është populluar me të dhëna fillestare dhe balancimi i ofertës dhe përdorimit më në fund mund të fillojë. Në misionet paraprake, është rezervuar një hapësirë në rrjetin kompjuterik në ASK. Rrjeti tani përmban udhëzues se ku ruhen manualët në Excel me kalkulimet e të dhënave për inpute. Një udhëzues tjetër përmban manualin në Excel me kornizën e SUT dhe macro faqen, që përmban macros vizuel bazik që përdoret për ekstraktim, modifikim ose rregullim automatik të balanceve të produkteve. Personat, që punojnë në balancimin e produkteve, do të punojnë në një kopje të kornizës SUT, por është e mundur të futen korrigjimet direkt edhe në versionin qendror të kornizës.

Shumica e stafit të llogarive kombëtare ka qenë prezente gjatë aktivitetit të balancimit, që kemi realizuar. Janë selektuar një numër produktesh. Produktet janë ekstraktuar në tabela që kanë ofruar një vështrim të versionit fillestar të balanceve të produkteve relevante. Në secilin rast është diskutuar nëse duhet të fshihen disa përdorime të produkteve, nëse duhet të shtohen të tjera, ose nëse disa përdorimeve duhet t'i shënohet vlera më e lartë apo më e ulët. Aty ku janë gjetur dallime, janë bërë korrigjimet e duhura. Vlerat, që nuk duhet të korrigjohen manualisht, janë larguar (ose janë ndryshuar me një koment duke shtuar një shenjë në fillim të identifikimit). Vlerat në pjesën e marzhave të tregtisë, taksave minus subvencionet dhe TVSH në shumicën e rasteve janë fshirë, pasi kalkulimi i tyre duhet të bëhet sipas formulave të ofruara në sistem. Shpjegimet për mënyrën e korrigjimeve janë shtuar si komente në faqen e korrigjimit dhe janë ruajtur si dokumentacion mbi arsyeshmerinë për vlerat e përzgjedhura.

Kur shtohen korrigjimet manuale të balanceve të produktit, ana ofruese dhe përdoruese nuk balancohen domosdoshmërisht. Zakonisht mjafton të reduktohen dallimet midis anës ofruese dhe përdoruese deri në vlera të vogla. Rregullimet e tjera bëhen në mënyrë automatike nga macro, duke shtypur një buton.

Koha në dispozicion nuk ka lejuar që të alancohen të gjitha produktet gjatë këtij misioni. Megjithatë, duhet të jetë e mundur të vazhdohet puna nga stafi i llogarive kombëtare.

Disa balancimeve specifike duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë. Gjatë misionit, ne kemi shikuar bagëtinë, produktet e qumështit dhe përdorimin e energjisë. Ekspertët danezë planifikojnë të përfundojnë punën në balancimin e produkteve të komplikuar. Faqet e korrigjuara mund të shkëmbehen përmes emailit dhe të futen në sistemin qendror në ASK.

Fazat në vijim, po ashtu do të kërkojnë asistencë nga ekspertët. Kur të balancohen produktet, disa totale të kolonave do të dallojnë nga caqet e tyre. Me siguri do të jetë e nevojshme të zhvendoset ana përdoruese e produkteve specifike në mes të industrive ose tek përdorimet e tjera para se të bëhet balancimi final automatik. Faza e fundit do të jetë balancimi final i anës ofruese dhe përdoruese të marzhave të tregtisë dhe transportit. Zakonisht, bëhet me ndihmën e macros, që mund të rregullojë fushat e selektuara të sistemit të totaleve të kolonave dhe rreshtave.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet.

Pavarësisht faktit që termat e references e përshkruajnë projektin e SUT vetëm si studim fizibiliteti, ekspertët danezë kanë vazhduar më tej me ndërtimin e kapaciteteve dhe përpilimin e tabelave ofruese përdoruese për vitin 2013. Për shkak të vonesave në fillim të projektit, plani për finalizimin e SUT është modifikuar më shumë se një herë dhe në misionin aktual nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për

të përfunduar balancimin e SUT. Megjithatë, ne besojmë që me angazhimin e ekspertëve dhe stafit të ASK-së mund të prodhohet një grup tabelash në një periudhë të shkurtër kohore. Stafit në ASK duhet po ashtu të ketë një përshkrim të shkruar se si duhet të bëhet balancimi final. Ne mendojmë që kjo është mënyra e duhur për të finalizuar projektin.

Si studim fizibiliteti, projekti ka qenë i suksesshëm. Ne kemi arritur të konvertojmë burimet e të dhënave në dispozicion, në një formë që mund të përdoret për të prodhuar sistemin SUT të finalizuar. Procesi ka demonstruar një numër mangësish në grumbullimin e statistikave. Statistikat ASN dhe PRODCOM ende mund të konsiderohen të natyrës eksperimentale. Është e qartë që rezultatet prej projektit në një mënyrë do të jenë të pasigurta dhe ka hapësirë për përmirësim. Puna shtesë me PRODCOM dhe ASN edhe pse e paparashikuar shpresojmë që do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së këtyre statistikave shumë të rëndësishme në vitet në vijim.

Duhet të përmendet fakti që është shumë e vështirë të vlerësohet shkalla e nënraportimit në burimet statistikore administrative. Teorikisht, duhet poashtu të shtohet një shtojcë për aktivitetin e njësive, që nuk mbulohen nga keto burime. Aktualisht, një qasje sistematike e përfshirjes të këtyre nën vlerësimeve nuk ekziston në Kosovë.

Duhet të ceket që llogaritë kombëtare në ASK kanë staf të pamjaftueshëm. Largimi i dy stazhiereve, të cilat kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë në suksesin e kodimit të burimit të dhënave, mund të thuhet se është një humbje e kapaciteteve të ndërtuara. Edhe pse ne me siguri do të jemi në gjendje së shpejti të prodhojmë versionin final të SUT për vitin 2013, sukcesi real i projektit do të jetë nëse prodhimi i SUT mund të vazhdojë në të ardhmen. Finalizimi i punës mund të kërkojë të paktën edhe një mision shtesë brenda vitit të ardhshëm. Në qoftë se një mision i tillë mund të organizohet, kjo mund të ketë një efekt vendimtar në ngritjen e kapaciteteve.

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahja për Statistika

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.6.6: SUT aktiviteti VI.

Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e llogarive kombëtare në Kosovë, me fokus në tabelat ofruese përdoruese

Orari:

TeR –data e përgatitjes: 12 Shkurt 2016

Fillimi / fundi i aktivitetit: 22 Shkurt – 4 Mars 2016

Koha e raportimit: 11 Mars 2016

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi logjik	Pikë referimi	Burimi i informacionit	Sugjerimet
2.3.1	Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raportet e misioneve, të publikuar në faqen e internetit të projektit - Fushat e caktuara të Llogarive Kombëtare, të përditësuara sipas ESA2010	- Raportet tremujore të projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i përditësuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e dytrave, që lidhen me projektin në mes të misioneve - Qasje në statistikat primare të sakta - Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat,

				rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.6.6

Përkrahja në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë. Fokus në Tabelat ofruese-përdoruese (SUT). Ky mision është vazhdimësi e misionit me Z. Søren Larsen 2.6.5 në Janar 2016. Pasi ky është misioni i fundit mbi SUT, puna rreth SUT, nëse është e mundur, do të përfundohet në kuadër të këtij misioni.

Misioni 2.6.5 ka konkluduar që:

Pasi statistikatat PRODCOM janë ngritur në një standard të përshtatshëm për përdorim në përpilimin e SUT, vëmendja është kthyer në ato pjesë të ASN, që kërkonin një kalkulim të shifrave për tregti dhe ndërtimtari. Ka pasur punë shtesë, para se të imputoheshin vlerat për blerje, rishitje dhe konsum të ndërmjetëm për disa ndërmarrje, që nuk janë përgjigjur në pyetësor. Kryesisht në kuadër të industrive të tregtisë, këto imputime janë të rëndësishme. Statistikat e TVSH-së vetëm nuk mund të ofrojnë informata mbi outputet dhe inputet, nëse nuk kemi njohuri për aksionet e blerjeve që përdoren për mallra për rishitje dhe konsum të ndërmjetëm.

Gjatë punës rreth ASN-së, është bërë e qartë që qarkullimi i disa ndërmarrjeve nën raportohet. Është hartuar një plan për të rregulluar totalin e outputit, për disa industri. Disa punë shtesë mbi këtë çështje duhet të bëhen nga konsulentit gjatë javëve në vijim, para misionit të radhës.

Për shkak të vonësave të mëhershme, ende ka nevojë që çështjet e pazgjidhura të zgjidhen në një kohë relativisht të shkurtër. Pas misionit paraprak është rekomanduar që dy misionet e ardhshme të mbahen në Shkurt dhe Mars 2016. Pas këtij misioni na nevojitet kohë e mjaftueshme për të përgatitur të dhënat për SUT dhe për balanacimin e ofertës dhe përdorimit

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.6.6:

Raporti i misionit, që përshkruan rezultatet e kodimit të dhënave, që do të përdoren për SUT

Rekomandimet për përfundimin e SUT në ASK

Përshkrimi i punës së bërë gjatë misionit dhe punës që duhet bërë pas projektit të Binjakëzimit

Stafi i ASK-së:

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rksgov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krap, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapi@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Z. Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk

Z. Peter Rørmose Jensen, Këshilltar i Lartë, Statistikat e Danimarkës, prj@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA), i përgatitur nga Eurostat-i, deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK-ja, me mbështetjen e IPA-s, ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërfshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare, së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

Projekti i Binjakëzimit deri tani ka pasur disa aktivitete në Komponentin #2 Llogaritë Kombëtare përfshirë misionin e gjetjes së fakteve mbi SUT

Aktivitetet, që duhet të ndërmerren në përgatitje të misionit:

- Raportet e misionëve të kaluara në komponentin e LLK. Të gjitha të publikuara në www.dst.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Zhvillimi i më tej i planit të detajuar për veprimet e ardhshme mbi SUT nga program i binjakëzimit
- Përfundimi i kodimit të dhënave (nëse është e mundur)

Rezultatet e pritura janë:

- Raporti i misionit – sipas modelit
- Plani i detajuar për aktivitetet e mëtejme në komponentin 2 nga programi i binjakëzimit
- Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren pas Binjakëzimit

Aneksi 1. Programi, Shkurt 2016

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	ASK: Rishikim i punës së bërë nga misioni i kaluar 2.6.5 mbi SUT në Shkurt 2016
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	Diskutimi mbi planet për këtë javë
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Punë praktike me të dhënat për SUT
2	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
3	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
4	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
5	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
6	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
7	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
8	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
9	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT Diskutimi mbi rekomandimet Plani për misionin e ardhshëm dhe si të veprohet para misionit të radhës Shkrimi i raportit
10	ASK	10:00-12:00	Shkrimi i raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA